

**RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË STUDIMEVE,
AFTËSIMIT, KURSEVE DHE TË TRAJNIMEVE SI DHE TARIFAVE PËRKATËSE
PËR SHËRBIME
NË KOLEGJIN TEMPULLI**

Duke siguruar një qasje moderne, profesionale, transparente në respektim të diversitetit, të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta për të gjithë, me qëllim të definimit të përmbajtjes së obligimeve dhe detyrimeve financiare, përgjegjësisë që rrjedhin nga këto obligime dhe duke u bazuar në statutin e Kolegjit Tempulli është hartuar kjo rregullore.

Me këtë rregullore përcaktohen bazat dhe kriteret, lidhur me tarifat e pagesave në emër të shërbimeve të ofruara në Kolegjin Tempulli në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm Tempulli). Shërbimet e ofruara përmes Qendrës për zhvillim dhe hulumtim profesional (QZHHP), parashihen me nenet 46, 48 dhe 49 të Statutit të Tempullit.

Përveç burimeve të përgjithshme financiare nga Fondet e themeluesve, fondet publike të akredituara me procedurë të veçantë, të ardhurat nga veprimtaria komerciale dhe aktivitetet tjera shkencore, profesionale, ekspertizave, projekteve, etj. realizohen përmes QZHHP edhe disa kurse dhe programe aftësuese-trajnuese.

Neni 1

Tempulli si subjekt privat me të drejtë publike i akredituar dhe si person juridik, me veprimtari arsimore dhe trajnuese, mund të sigurojë dhe të marrë financime nga fondet e dedikuara edhe nga institucionet qeveritare dhe institucionet tjera ndërkombëtare.

Neni 2

Procedurat dhe tarifat e Arsimit dhe pagesat për Kualifikimet, trajnimet dhe aftësimet profesionale

2.1. Kualifikimi: CPC-C Menaxher i transportit të mallrave

Dokumentet: Fletëparaqitja plotësohet me rastin e regjistrimit; Certifikata mjekësore; Letërnjoftimi ose pasaporta; Pagesa e trajnimit me rastin e regjistrimit.

Provimi: Komisioni i përbashkët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Tempulli.

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 300.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura provimi dhe certifikata)

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata/diploma përkatëse.

2.2. Kualifikimi: CPC-D Menaxher i transportit të udhëtareve

Dokumentet: Fletëparaqitja plotësohet me rastin e regjistrimit; Certifikata mjekësore; Letërnjoftimi ose pasaporta; PAGESA e trajnimit me rastin e regjistrimit.

Provimi: Komisioni i përbashkët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Tempulli

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 300.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata/diploma përkatëse.

2.3. Kualifikimi: CPC-D (bartje të udhëtareve/shofer autobusi)

Dokumentet: Fletëparaqitja plotësohet me rastin e regjistrimit; Certifikata mjekësore; Letërnjoftimi ose pasaporta; PAGESA e trajnimit me rastin e regjistrimit.

Provimi: Komisioni i përbashkët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Tempulli

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 100.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i aplikacionit për shërbime rreth trajnimit: 50.00 euro, ku përfshihen vendosja e të dhënave në Sistemin për menaxhimin e të dhënave, nënshkrimi dhe evidentimi i certifikatave në MMPHI dhe shërbimet tjera administrative.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 30.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.4. Kualifikimi: CPC-C (bartje të mallrave/shofer kamioni)

Dokumentet: Fletëparaqitja plotësohet me rastin e regjistrimit; Certifikata mjekësore; Letërnjoftimi ose pasaporta; PAGESA e trajnimit me rastin e regjistrimit.

Provimi: Komisioni i përbashkët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Tempulli

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 100.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i aplikacionit për shërbime rreth trajnimit: 50.00 euro ku përfshihen vendosja e të dhënave në Sistemin për menaxhimin e të dhënave, nënshkrimi dhe evidentimi i certifikatave në MMPHI dhe shërbimet tjera administrative.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 30.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.5. Kualifikimi: ADR (transporti i mallrave të rrezikshme)

Dokumentet: Fletëparaqitja; Fotokopja e letërnjoftimit ose pasaportës; Fotokopja e patentë shoferit për kategorinë përkatëse; Fletëpagesa (për ndjekjen e kursit); Fletëpagesa në llogari të Ministrisë së Infrastrukturës (për provim).

Provimi: Komisioni i përbashkët nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Tempulli

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 100.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.



TEMPULLI

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org

Çmimi i aplikacionit për shërbime rreth trajnimit: 50.00 euro ku përfshihen vendosja e të dhënave në Sistemin për menaxhimin e të dhënave, nënshkrimi dhe evidentimi i certifikatave në MMPHI dhe shërbimet tjera administrative.
Çmimi i fletëpagesës së provimit që paguhet në MMPHI: 50.00 euro ku përfshihen provimi, certifikata përkatëse dhe kartela e transportuesit.

2.6. Kualifikimi: TACHO (tahografët digjital)

Dokumentet: Fletëparaqitja; Fotokopja e letërnjoftimit ose pasaportës; Fotokopja e patentë shoferit për kategorinë përkatëse; Fletëpagesa (për ndjekjen e kursit); Fletëpagesa në llogari të Ministrisë së Infrastrukturës (për provim).

Provimi: Komisioni nga Tempulli

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 100.00 euro, ku përfshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i aplikacionit për shërbime rreth trajnimit: 50.00 euro ku përfshihen vendosja e të dhënave në Sistemin për menaxhimin e të dhënave

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përfshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.7. Kualifikimi: Operuesit e impianteve të vinçave, ngritjeve dhe të ngjashëm

Certifikimi I: Operimi me vinç (VINÇ-01)

Numri i kredive : 7 Kredi

Çmimi: 580.00 euro

Dokumentet: Fletëparaqitja për regjistrim; fotokopja e letërnjoftimit/pasaportës; fotokopja e patentë shoferit, diploma e shkollës së mesme (origjinale ose e noterizuar).

M1 - Hyrje në profesionin e operuesit të impianteve të vinçave, ngritjeve dhe të ngjashëm (1 Kredi) – 7 orë teori , 3 orë vlerësim . Gjithsejtë 10 orë ;

M2 - Operimi me vinçin (5 Kredi) – 15 orë teori, 30 orë praktikë dhe 7 orë vlerësim. Gjithsejtë 52 orë;

M5- Mbrojtja në punë dhe ruajtja e mjedisit (1 Kredi) – 4 orë teorike, 3 orë praktike dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë.

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 530.00 euro, ku përfshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përfshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.8. Kualifikimi: Operuesit e impianteve të vinçave, ngritjeve dhe të ngjashëm

Certifikimi II: Operimi me pirunier (PIRUN-02)

Numri i kredive : (7 Kredi)

Çmimi: 550.00 euro

Dokumentet: Fletëparaqitja për regjistrim; fotokopja e letërnjoftimit/pasaportës; fotokopja e patentë shoferit, diploma e shkollës së mesme (origjinale ose e noterizuar).

M1 - Hyrje në profesionin e operuesit të impianteve të vinçave, ngritjeve dhe të ngjashëm (1 Kredi) – 7 orë teori , 3 orë vlerësim . Gjithsejtë 10 orë ;

M3 - Operimi me pirunier me veprim vertikal, horizontal dhe këndor (5 Kredi), 14 orë teori, 30 orë praktikë dhe 10 orë vlerësim. Gjithsejtë 54 orë ;



TEMPULLI

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org

M5- Mbrojtja në punë dhe ruajtja e mjedisit – 4 orë teorike, 3 orë praktike dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë.

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 500.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.9. Kualifikimi: Operuesit e impianteve të vinçave, ngritjeve dhe të ngjashëm

Certifikimi III: Operimi me ashensor të ndërtimit (LIFT-03)

Numri i kredive (6 Kredi)

Çmimi: 530.00 euro (480.00 euro trajnimi+50.00 euro certifikata)

Dokumentet: Fletëparaqitja për regjistrim; fotokopja e letërnjoftimit/pasaportës; fotokopja e patentë shoferit, diploma e shkollës së mesme (origjinale ose e noterizuar).

M1 - Hyrje në profesionin e operuesit të impianteve të vinçave, ngritjeve dhe të ngjashëm

(1 Kredi) – 7 orë teori - 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë ;

M4 - Operimi me ashensorin e ndërtimit (4 Kredi), 5 orë teori, 30 orë praktike dhe 8 orë vlerësim. Gjithsejtë 43 orë ;

M5- Mbrojtja në punë dhe ruajtja e mjedisit – 4 orë teorike, 3 orë praktike dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë.

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 480.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.10. Kualifikimi: Operuesit e kamionëve për ngritje

Certifikimi I: pozicionimi dhe vendosja e ngarkesës (PVN-01)

Numri i kredive (3 Kredi)

Çmimi: 410.00 euro.

Dokumentet: Fletëparaqitja për regjistrim; fotokopja e letërnjoftimit/pasaportës; fotokopja e patentë shoferit, diploma e shkollës së mesme (origjinale ose e noterizuar).

M1- Hyrje në profesionin e operuesit të autovinçave (1 Kredi), 7 orë teori dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë;

M8 - Pozicionimi dhe vendosja e ngarkesës (1 Kredi) , 3 orë teori, 5 orë praktikë dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 11 orë;

M9- Mbrojtja në punë dhe ruajtja e mjedisit – 4 orë teorike, 3 orë praktike dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë.

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 360.00 euro, ku përshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.11. Kualifikimi: Operuesit e kamionëve për ngritje

Certifikimi II: Bartja dhe transferimi i ngarkesës në vendndodhjen e saj të caktuar (BTN-02)

Numri i kredive (5 Kredi)

Çmimi: 410.00 euro.



TEMPULLI

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org

Dokumentet: Fletëparaqitja për regjistrim; fotokopja e letërnjoftimit/pasaportës; fotokopja e patentë shoferit, diploma e shkollës së mesme (origjinale ose e noterizuar).

M1- Hyrje në profesionin e operuesit të autovinçave (1 Kredi), 7 orë teori dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë;

M7 - Bartja dhe transferimi i ngarkesës në vendndodhjen e saj të caktuar (3 Kredi) , 5 orë teori, 25 orë praktikë dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 33 orë;

M9- Mbrojtja në punë dhe ruajtja e mjedisit (1 Kredi) – 4 orë teorike, 3 orë praktike dhe 3 orë vlerësim. Gjithsejtë 10 orë .

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 360.00 euro, ku përfshihen ligjëratat, ushtrimet dhe literatura.

Çmimi i fletëpagesës së provimit: 50.00 euro ku përfshihen provimi dhe certifikata përkatëse.

2.12. Kualifikimi: Instruktor i shoferëve

Provimi: (provimet e fundit në teori dhe praktikë) Komisioni i përbashkët nga Tempulli

Çmimi: 970.00 euro.

Kushtet për regjistrim-dokumentet: Mosha mbi 25 vjeçare; Letërnjoftim e noterizuar; Patentë shofer te kategorisë B se paku 5 vite e noterizuar; Diplome te shkollës se mesme, origjinale ose e noterizuar; Certifikatë gjyqësore qe nuk është nen hetime (jo me te vjetër se 6 muaj - origjinale ose e noterizuar; Certifikatë mjekësore (jo me te vjetër se 3 vite-origjinale ose e noterizuar).

Çmimi i regjistrimit të trajnimit: 970.00 euro, ku përfshihen regjistrimi, literatura, vijimi i ligjëratave dhe ushtrimeve laboratorike, aftësimi praktik, provimet dhe certifikata.

Çmimi i fletëpagesës së provimit teori: 50.00 euro ku përfshihen provimi final në teori.

Çmimi i fletëpagesës së provimit praktikë: 50.00 euro ku përfshihen provimi final në praktikë.

2.13. Aftësimi në auto shkollë

Kushtet për regjistrim-dokumentet: Mosha 18 vjet e tutje; letërnjoftimi, certifikata mjekësore Vërtetimi/certifikata e Kryqit të Kuq.

Programi aftësues: 20 orë mësimore në teori dhe 20 orë ushtrime praktike.

Çmimet: 275.00 euro-regjistrimi i aftësimit me 20 orë plus tërheqja e dokumenteve 25.00 euro;

Provimet: Paraqitja e provimit në teori në Ministri 10.00 euro; paraqitja e provimit në praktikë 10.00 euro në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dërgimi i automjetit për provim praktik është 20.00 euro dhe paguhet në auto shkollë (bankë).

Neni 3

Tarifat e studimeve (BA, BSC, MSC) dhe pagesat për shërbimeve tjera janë:

- Tarifa për studime Bachelor (BA) është 1800.00 Euro për vit akademik;
- Përsëritja e vitit BA është pagesa e vlerës së 20 % të çmimit për një vit studimi,
- Përsëritja e vitit BSC është pagesa e vlerës së 20 % të çmimit për një vit studimi;
- Përsëritja e vitit MSC është pagesa e vlerës së 20 % të çmimit për një vit studimi.
- Nxjerrja e vërtetimit mbi statutin e studentit (BA, BSC dhe MSC) është 20.00 Euro;



TEMPULLI

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org

- Diploma origjinale dhe transkripti i notave (BA, BSC dhe MSC) me rastin e diplomimit për studentin janë falas;
- Kopja e Diplomës (BA, BSC dhe MSC) është 10.00 Euro;
- Pagesa për provime në afate jo të rregullta për studime (BA dhe BSC) 10.00 Euro, për studime (MSC) është 20.00 Euro;
- Pagesa për kurse (lëndë) dhe provime diferenciale është 100.00 Euro;
- Paraqitja e temës së diplomës (BA dhe BSC) dhe mbrojta para komisionit vlerësues është 200.00 Euro;
- Paraqitja e temës së diplomës (MSC) dhe mbrojta para komisionit vlerësues është 400.00 Euro;
- Përgatitja e planit dhe programit (syllabuset sipas lëndëve) dhe sipas programeve studimore, që ka vijuar studenti gjatë studimeve në nivelet (BA, BSC dhe MA, MSC) është 30.00 Euro.

Neni 4

Secili dokument i cili lëshohet sërish si duplikat paguhet në tarifën burimore varësisht nga lloji i trajnimit.

Neni 5

Pagesa e përnjëhershme dhe në mënyrë grupore mundëson zbritje prej 5-10 %. Kjo zbritje mund të vlej vetëm për Kualifikimet kombëtare të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Neni 6

Vlera e çmimit për pagesën së trajnimeve mund të ndryshojë, por në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshojë gjatë kryerjes së trajnimit të caktuar, por mund të ndryshojë për grupet vijuese.

Neni 6

Për mos pagesë të borxheve të akumuluar të kandidatëve për secilin trajnim, do të veprohet përmes procedurës të përbarimit sipas Ligjit Nr. 05/I-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/I-139 për procedurën përbarimore.

Neni 8

Tempulli në asnjë mënyrë nuk është e obliguar që kandidatit t'i kthejë shumën e mjeteve financiare të paguara në emër të trajnimeve (secili trajnim), edhe nëse kandidati shtron një kërkesë të tillë me çfarëdo arsytimi.

Neni 9

Dokumentacionin adekuat dhe aktivitetet financiare, udhëhiqen nga shërbimi përkatës, në përputhje me dispozitat ligjore të aplikueshme. Pas hartimit të raporteve të këtij shërbimi, Këshilli Drejtues bënë vlerësimin dhe verifikimin e të dhënave të paraqitura, si dhe konfirmimin e të njëjtave si dokumente oficiele.



TEMPULLI

Rr. Eduard Lir 158, Arbëria
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038 22 22 55, 038 60 40 20
Fax: 038 60 40 19
Web: www.tempulli.org
Email: info@tempulli.org

Neni 10

Këshilli Drejtues i Kolegjit mban përgjegjësin e mirëvajtjes të saj, si dhe drejtpërsëdrejti përcakton mënyrën dhe shfrytëzimin si dhe ndarjen e fondeve duke pamundësuar shpërdorimet financiare. Këshilli gjithashtu mbanë të drejtën që në raportet periodike dhe vjetore të shërbimit të kontabilitetit, në rast nevojë të kryhet revizioni – kontrolli financiar, nga komisioni profesional.

Neni 11

Dokumentacioni administrative, financiar, kontraktues, fuqizohet me aprovim nga Këshilli Drejtues, dhe nënshkrim nga kryetari i Këshillit.

Neni 12

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregullore bëhen sipas mënyrës dhe procedurës me të cilën është aprovuar kjo rregullore.

Neni 13

Rregulloja kështu në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues dhe e shfaqet rregullisht me nr.027/23, të datës 08.12.2023.

Këshilli Drejtues

Dr. Sc. Ena Benisha Krasniqi, Kryetare

Akademia Tempulli



2